



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Shk II.nr.211/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përbarimore të kreditorit NNSH “Emsa” me seli ne Suharek, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson Qazim Hasanaj avokat nga Suhareka, kundër debitorit Komuna e Prizrenit, e te cilën sipas autorizim e përfaqëson Blerim Mazreku avokat ne Prizren, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2498/22 i datës 09.11.2023, me datë **04.06.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit NSH “Emsa” me seli ne Suharek, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2498/22 i datës 09.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2498/22 i datës 09.11.2023 në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit Komuna e Prizrenit, ndërsa ka anuluar urdhrin përbarimor P.nr.1423/2022, i datës 21.10.2022, i lejuar nga Përbaruesi Mehdi Reshani me seli të zyrës në Prizren.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2498/22 i datës 09.11.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori NNSH “Emsa” me seli ne Suharek, me datën 21.10.2022 ka paraqitur propozimin për përmbarim në bazë të dokumentit - Faturë me nr: 08/2020 e datës 31.12.2020, ka lejuar përmbarimin me Urdhrin Përmbarimor P.nr.1423/22, të datës 21.10.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që të përmbush prestimin obligator ndaj kreditorit në shumën 2.284,50 duke llogaritur edhe kamatën ligjore 8% prej ditës së dorëzimit të propozimit deri në pagesën definitive.

Përmbaruesi Privat Mehdi Reshani me seli në Prizren duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me urdhrin përmbarimor P.nr.1423/2022, i datës 21.10.2022 e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbarimor Debitori, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor me arsyetim në dokument të besueshëm nuk është përcaktuar afati 7 ditor i përmbushjes së detyrimit, e po ashtu nuk është përcaktuar afati për përmbushje as në propozim për përmbarim. Po ashtu në kundërshtime ka theksuar se borxhi është i parregullt, dhe nuk paraqet prestim adekuat në raportin kreditor - debitor. Ka kërkuar të miratohet prapësimi i debitorit dhe urdhri përmbarimor të anulohet dhe refuzohet propozimi për përmbarim si dhe të obligohet kreditori që debitorit ti paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimit dhe të gjitha shpenzimet tjera, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabaza dhe ka theksuar se të njëjtat kanë për qëllim prolongimin e përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga puna juridike e vlefshme. Shton se debitori në kundërshtim me faktet e pretenduara, vërteton faktin se në mes të palëve ka pasur një raport juridik dhe mbi bazën e këtij raporti juridiko civil, këtu pala kreditore, ka lëshuar faturat, të cilat janë dokument i besueshëm, pra dokument i rregullt përmbarimor. Nga gjykata kërkoj ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2498/22 të datës 09.11.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit Komuna e Prizrenit, ndërsa ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.1423/2022, i datës 21.10.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Mehdi Reshani me seli të zyrës në Prizren.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se dokumenti - fatura 08/2020 e datës 31.12.2020 në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në faturë nuk është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, duke e bere te paqartë faktin e arritjes së faturës për pagese, po ashtu gjykata ka konstatuar se pala kreditore nuk ka përcaktuar afatin e përmbushjes as përmes deklaratës me shkrim, e as në propozim për përmbarim.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është*

treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.Dh.Shk II.nr.211/24, me datë 04.06.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami